

“DEAPRINT” Sh.p.k

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Tiranë, 26 shkurt 2021

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Performancës.....	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital.....	3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	4
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare	5-22



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për pronarët e Shoqërise “DEAPRINT” Sh.p.k,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “DEAPRINT” sh.p.k, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet material, pozicionin financiar të Shoqërise më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.



“FILTO Auditing” sh p k

- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne muund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, 26 shkurt 2021

FILTO Auditing sh.p.k

Tatjana FILTO,

Audituese Ligjore



“DEAPRINT” sh p k

Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktivët afatshkurtra			
Mjete Monetare dhe ekuivalentë të tyre	4	9,465,916	5,941,610
Llogari të Arkëtueshme	5	10,122,682	17,733,804
Të tjera të arkëtueshme	6	4,965,417	7,093,500
Inventari	7	21,683,176	33,818,203
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		46,237,191	64,587,117
Aktivët Afatgjata			
Aktive Afatgjata Materiale	8	732,857,313	742,937,389
Totali i Aktiveve afatgjata		732,857,313	742,937,389
TOTALI I AKTIVEVE		779,094,504	807,524,506
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtra			
Huamarrjet	9	49,378,586	48,943,663
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	10	35,886,542	50,052,946
Parapagime të arkëtuara	11	123,700	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		85,388,828	98,996,609
Detyrimet Afatgjata			
Huamarrjet	9	61,275,254	76,283,040
Totali i detyrimeve afatgjata		61,275,254	76,283,040
TOTALI I DETYRIMEVE		146,664,082	175,279,649
KAPITALI			
Kapitali aksionar	12	628,196,000	628,196,000
Rezerva të tjera		4,048,857	3,530,780
Humbja e vitit		185,565	518,077
Totali i Kapitalit		632,430,422	632,244,857
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		779,094,504	807,524,506

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë “Deaprint” sh.p.k më 12 shkurt 2021 dhe janë firmosur nga:

Z. Redin Jegeni
Administrator i Përgjithshëm



Znj. Marjana Mero
Ekonomiste



Pasqyra e Performancës

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shitjet neto	13	195,894,604	270,368,273
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	14	6,720,000	7,458,000
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces		310,540	97,325
Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet	15	(119,710,371)	(183,306,108)
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	16	(27,361,021)	(37,728,485)
Shpenzime të personelit	17	(37,501,329)	(40,330,817)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	8	(10,123,409)	(12,656,736)
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit		8,229,014	3,901,452
Shpenzimet financiare neto	18	(7,943,384)	(3,130,811)
Fitimi para tatimit		285,630	770,641
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	19	(100,065)	(252,564)
Fitimi neto i vitit financiar		185,565	518,077
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		185,565	518,077

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashperndare	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	628,196,000	1,809,587	1,721,193	7,458,000
Fitimi neto i vitit financiar	-	-	518,077	518,077
Rritje e rezervës së kapitalit	-	1,721,193	(1,721,193)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	628,196,000	3,530,780	518,077	632,244,857
Fitimi neto i vitit financiar	-	-	185,565	185,565
Rritje e rezervës së kapitalit	-	518,077	(518,077)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	628,196,000	4,048,857	185,565	632,430,423

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fluksi parasë nga aktiviteti operacional			
Fitimi para tatimit		285,630	770,641
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime interesi	18		
Shpenzime amortizimi	8	10,123,409	12,656,736
		10,409,039	13,427,377
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Rënie në llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	5, 6	9,739,205	210,656
Rënie/ (Rritje) në Inventarë	7	12,135,027	(7,113,669)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	10	(14,048,507)	26,074,252
Rritje në parapagime të arkëtuara	11	123,700	-
Mjete monetare neto nga veprimtaria e shfrytëzimit		23,544,860	38,091,124
Interes i paguar	18	(5,186,396)	(5,492,509)
Tatim fitim i paguar		(217,962)	(416,953)
Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional		18,140,502	32,181,662
Fluksi parasë nga aktiviteti investues			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(43,333)	(7,739,255)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga aktivitetet investuese		(43,333)	(7,739,255)
Fluksi parasë nga aktivitetet financuese			
Hua të marra		12,000,000	-
Ripagim i huave të marra		(26,572,863)	(32,263,997)
Fluksi parasë neto nga aktivitetet financuese		(14,572,863)	(32,263,997)
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		3,524,307	(7,821,590)
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fillim të periudhës		5,941,610	13,763,200
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fund të periudhës	4	9,465,916	5,941,610

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 22 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1 Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria “DEAPRINT” sh.p.k (këtu e më poshtë referuar si “shoqëria”) është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim të ortakëve të datës 16-prill 2010 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 27 prill 2010.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria ka si objekt të ofrojë shërbime në fushën e shtyshkronjave duke përfshirë dhe punime speciale tipografie të të gjitha llojeve. Importim, instalim dhe shitje linjash dhe impiantesh tipografike të të gjitha llojeve pjesë këmbimi për to, materiale ndihmëse dhe lëndë të parë për produktet tipografike. Import-eksport të mallrave, letër të llojeve për produktet tipografike. Bashkëpunim dhe operim me shoqëri vendase dhe të huaja, për operime reciproke si nënkontraktor i operatoreve në fushën e shtypshkrimeve si dhe në aktivitetet tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë. Shitblerje të pasurive të paluajtshme të çfarëdolloji dhe dhënie me qera të tyre, për interesa të shoqërisë.

Në vitin 2020 shoqëria ka kryer aktivitetin në shtypjen e librave dhe fletëpalosje.

Kontributi në kapitalin e shoqërisë përfaqësohet nga kapitali i tre ortakëve.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në ambiente prodhimi në komunën Kashar. Aktivitetet e saj përbehen nga toka, ndertesa, makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike.

Kapitali i shoqërisë në shumën 628,196,000 lekë, kapital i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me ndarjen sipas ortakëve paraqitet si më poshtë:

	%	Kapitali total
ALBAS	51	320,379,960
RADIN	26	163,330,960
REDIN JEGENI	23	144,485,080
	100	628,196,000

Shoqëria drejtohet nga: Administratori që është ortak në shoqëri. Atij i perkasin të gjithë kompetencat për drejtimin ekzekutiv të përgjithshëm. Administratori i shoqërisë është Z.Redin Jegeni i emëruar më 10 dhjetor 2020.

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2020 ka qenë 40 punonjës.

2 Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (“KKK”). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2).

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

2.4 Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë.

Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

3.1 Instrumentat financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Të gjitha aktivitet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Shoqëria ka vetem instrumenta financiare jo derivative, përfshirë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, huamarrje, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Mjetet Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshinë paratë në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra shumë likuide me afat maturimi deri në tre muaj.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me kosto të amortizuar, pra me vlerën e koston së tyre minus zhvlerësimet e krijuara për rënie në vlerë. Zhvlerësimet e lejuara mund të llogariten, për shumat e vlerësuara si të parikuperueshme, në Pasqyrën e Performancës kur ekziston një evidencë objektive që këto kërkesa janë zhvlerësuar më parë.

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme njihen me vlerën e drejtë të tyre që është shuma e pritshme e pagesa të ardhme që do të kryhen për shuarjen e detyrimit. Në fund të periudhës raportuese Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme maten me koston e amortizuar.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Instrumentat financiare (vazhdim)

Huamarrjet

Huamarrjet maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme). Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto të amortizueshme duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

Aktivitet dhe detyrimet financiare klasifikohen si afatshkurtra përveç rasteve kur shoqëria ka të drejtë të pakushtezuar të ndryshojë marreveshjen e huase për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

3.2 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvlerësohet nëse ekzistojnë tregues sipas të cilëve një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi në rastin e një aktivi financiar të vlerësuar me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabel (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të një rëndësie të veçantë testohen për zhvlerësim individualisht. Pjesa tjetër e aktiveve vlerësohen së bashku, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbja nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ajo mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit. Për aktivet financiare të vlerësuara në kosto të amortizuara anulimi i zhvlerësimit njihet në fitim humbje.

3.3 Inventaret

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqëria vlerëson inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësi ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.3 Inventarët (vazhdim)

Kostot e shkaktuara në sjelljen e secilit produkt në të vendndodhja dhe gjendja e tanishme llogariten si më poshtë: kosto direkte që lidhet me inventarët dhe ato shpenzimet e përgjithshme që kanë ndodhur në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale të tyre. Kosto e inventarit përfshin: kostoja e blerjes së mallrave, kostoja e transportit, detyrimet doganore, akciza etj

Vlera neto e realizueshme (VNR) përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuara të kompletimit dhe kostot e nevojshme për të bërë shitjen. Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron periodikisht çmimet e shitjes në koston e inventarit dhe nëse çmimi ulët nën koston, diferenca njihet në Pasqyrën e Performancës si Zhvlerësim i inventarëve. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare. Zbritja e duhur për ulje njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

3.4 Aktivet Afatgjata Materiale

(a) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit dhe sjelljen e tij në kushtet e nevojshme për funksionim. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje.

(b) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të mirmbajtjes të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

(c) Amortizimi/Zhvlerësimi

Pas njohjes fillestare, aktivet maten me kosto të amortizuar me metoden e vlerës së mbetur. Normat e amortizimit dhe metoda e amortizimit rishikohet çdo fund periudhe raportuese dhe nëse ka ndryshime ato aplikohen në mënyrë prospektive. Toka dhe ndertimet në proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.5 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile të aktiveve jofinanciare të Shoqërise, përveç inventareve dhe tatimeve të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvleresim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvleresimi njihet nëse vlera kontabile e një aktivi është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme të parase skontohehen në vlerën e aktuale duke përdorur normën e skontimit përpara takses që paraqet vlerësimin e tregut për vlerën në kohë të parase dhe riskun specifik të aktivitetit.

Për humbjet nga zhvleresimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues sipas të cilit humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvleresimi anulohet nëse kanë ndodhur ndryshimet në vlerësimet e bera për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvleresimi anulohet deri në atë masë që vlera kontabile e aktiveve të mos kalojë vlerën kontabile të aktiveve, minus amortizimin, që do të ishte përcaktuar nëse zhvleresimi nuk do të kishte ndodhur.

3.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vlerën nominale 1,000 leke secila.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërise.

Të ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësive së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

3.8 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara. Shpenzimet për kërkime e zhvillime përgjithësisht janë ngarkuar në llogarinë e shpenzimeve në periudhën se ciles i perkasin.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përmbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Shoqëria njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për atë që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për atë që nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenziemeve në momentin e ndodhjes.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.12 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR	123.70	121.77

3.13 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3.14 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.14 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

3.14.1 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Shoqëria njih detyrimin në rast të një kontrolli të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

3.14.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vjueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit që COVID-19 paraqiti për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë ndërmorën masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përjashtuar shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu udhëzuan punonjësit të qëndronin në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Ndikimet më të gjëra ekonomike të këtyre ngjarjeve përfshijnë:

- Nderprerje në operacionet e biznesit dhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri, me një ndikim bllokues në zinxhirët e furnizimit të brendshëm;
- Nderprerje e konsiderueshme për bizneset në sektorë të caktuar, si brenda Shqipërisë, ashtu edhe në tregjet me varësi të lartë nga një zinxhir i furnizimit të huaj, si dhe bizneset e orientuara nga eksporti me mbështetje të lartë në tregjet e huaja. Sektorët e prekur përfshijnë tregtinë dhe transportin, udhëtimin dhe turizmin, argëtimin, prodhimin, ndërtimin, shitjen me pakicë, sigurimet, arsimin dhe sektorin financiar;
- Ulje e konsiderueshme e kërkesës për mallra dhe shërbime jo thelbësore;
- Një rritje në pasigurinë ekonomike, e reflektuar në më shumë çmime të paqëndrueshme të pronave dhe kursit të këmbimit të valutave.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.14 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Aktiviteti i Shoqërisë nuk u ndërpre gjatë pandemisë dhe situatës së kufizimit të lëvizjeve. Shoqëria pati impakt në ulje të shitjeve si pasojë e uljes së të ardhurave nga shtypja e librit shkollor me 18.4% dhe ulja e të ardhurave nga shtypja e broshurave me 47.5% gjatë fazës së kufizimit të lëvizjeve dhe ndalimit të aktiviteteve të qëndrave tregtare dhe dyqaneve.

Bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht, në datën kur këto pasqyra financiare ishin të autorizuara për dorëzim, Drejtimi konsideroi një numër skeçarësh të besueshme në lidhje me zhvillimin e mundshëm të Covid-19 dhe ndikimin e tij të pritshëm në njësinë ekonomike dhe mjedisin ekonomik në të cilin njësinë ekonomike operon, përfshirë masat që pritet të merren nga qeveria. Drejtimi konsideroi faktin që njësinë ekonomike operon në një sektor të shtypshkrimit të librave dhe materialeve të tjera dhe se nuk pritet të ketë kufizime shtesë apo ndalim të aktivitetit tregtar gjatë 2021 dhe vlerëson që situata e pafavorshme do të rikuperohet gjatë 2021 ku pritet rritje e shitjeve.

Si rrjedhojë, drejtimi parashikon që Shoqëria do të ketë burimë të mjaftueshme për të siguruar vijueshmërinë e biznesit për një periudhë të paktën 12 muaj nga data e raportimit. Drejtimi arriti në përfundimin se tërësia e rezultateve të mundshme të konsideruara për të arritur në këtë gjykim nuk krijon paqartësi materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin.

4 Mjete Monetare

Mjetet Monetare (Likuiditetet) janë paraqitur në bilanc me gjendjen e llogarive bankare në fund të periudhës me datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019, të cilat janë të njëjta me ekstratin e fundit të bankave për këtë periudhë si dhe me gjendjen e Parave në arken e Shoqërisë.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Para në arkë	217,624	209,001
Para në Banka	<u>9,248,292</u>	<u>5,732,609</u>
Totali	<u>9,465,916</u>	<u>5,941,610</u>

“DEAPRINT” sh p k

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***5 Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020, paraqiten në bilanc me vlerën e tyre të drejtë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Spar Albania shpk	1,988,352	2,922,337
Ana 2011 shpk	712,800	684,000
Kraft	700,000	445,800
ALBAS	298,802	2,687,529
Shtepia Botuese Albas, Tetove	495,666	-
Albas Prishtina	-	924,234
Intergrafika	687,622	127,702
AK-Invest sha	612,000	-
Te Birra Stela	445,007	423,698
Pik	396,000	-
Celesi Design & Publicity	292,800	415,738
Gotech	214,440	691,080
Scandinavian Living	202,500	1,556,400
Eco Market food	192,600	673,248
Idriz Metani	174,600	-
V.Advertising	170,040	-
Diambe shpk	164,688	88,848
Tirana East Gate	-	828,000
UNDP	-	730,800
Gent Grafik	-	468,000
Texal	119,430	119,430
Sofije Kumi	-	250,000
Neptun	126,720	356,640
Big City	-	336,000
Bashkia Shkoder	-	244,800
Kliente të ndryshëm	2,128,616	2,759,519
Totali	<u>10,122,682</u>	<u>17,733,804</u>

Ne këto kërkesa bëjnë pjesë ato shitje mallrash dhe shërbime në fushën e shtypshkrimeve të pa arkëtuara që lidhen kryesisht me klientët e shoqërise, për të cilat vazhdon likuidimi i tyre.

6 Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më datë 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
TVSH	-	2,224,157
Dogana	5,225	27,048
Tatim Fitimi	167,303	49,406
Debitor er kreditor te tjere	4,792,888	4,792,888
Totali	<u>4,965,417</u>	<u>7,093,500</u>

7 Inventari

Gjendja e inventareve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Lendet e para	13,543,323	23,770,108
Materiale ndihmese dhe materiale te tjera	7,406,507	9,229,273
Produkte te Gatshme	407,865	97,325
Iventar I imet	325,481	721,497
Totali	<u>21,683,176</u>	<u>33,818,204</u>

Gjendja e materialeve dhe mallrave te blera paraqiten ne bilanc te vleresuara me koston e marrjes (kosto e blerjes), ne llogarite e klases 3, per shumat e paraqitura ne Bilanc.

Shoqëria ka ndjekur metoden e inventarizimit te vazhdueshem.

“DEAPRINT” sh p k

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumatat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

8 Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivët Afatgjata Materiale më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

Kosto	Toka	Ndertesat	Makinat dhe Pajisjet	Mjetet transporti	Inventar Ekonomik	Investime në proces	Totali
Më 1 janar 2019	123,768,274	443,110,472	330,198,852	2,446,108	7,546,531	105,000	907,175,237
Shtesa	-	-	8,198,333	-	697,537	40,000	8,935,870
Pakesime	-	-	(1,419,334)	-	-	-	(1,419,334)
Më 31 dhjetor 2019	123,768,274	443,110,472	336,977,851	2,446,108	8,244,068	145,000	914,691,773
Më 1 janar 2020	123,768,274	443,110,472	336,977,851	2,446,108	8,244,068	145,000	914,691,773
Shtesa	-	-	-	-	43,333	-	43,333
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-
Kapitalizim i investimit në proces	-	145,000	-	-	-	(145,000)	-
Më 31 dhjetor 2020	123,768,274	443,255,472	336,977,851	2,446,108	8,287,401	-	914,735,106
<i>Amortizimi i akumuluar</i>							
Më 1 janar 2020	-	54,573,302	98,441,430	1,807,596	4,498,039	-	159,320,367
Shtesa	-	4,662,446	7,131,074	127,702	735,514	-	12,656,736
Pakesime	-	-	(222,719)	-	-	-	(222,719)
Më 31 dhjetor 2019	-	59,235,748	105,349,786	1,935,298	5,233,553	-	171,754,384
Më 1 janar 2020	-	59,235,748	105,349,786	1,935,298	5,233,553	-	171,754,384
Shtesa	-	4,606,497	4,760,490	102,162	654,260	-	10,123,409
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	-	63,842,245	110,110,276	2,037,460	5,887,813	-	181,877,793
<i>Vlera Neto</i>							
Më 31 dhjetor 2019	123,768,274	383,874,724	231,628,065	510,810	3,010,515	145,000	742,937,389
Më 31 dhjetor 2020	123,768,274	379,413,228	226,867,575	408,648	2,399,588	-	732,857,313

Shoqëria ka shuar aktivet ne pronesi te saj me blerje te cilat jane paraqitur, vleresuar dhe kontabilizuar drejt, konform rregullave te vendosura nga Standartet Kombeare te Kontabiliteit.

8 Aktivët Afatgjata Materiale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve të Qendrueshme të Trupezuara për vitin 2020 është llogaritur nën normat fiskale të amortizimit, sipas normave të miratuara nga pronarët e shoqërisë në bazë të shfrytëzimit të kapacitetit të prodhimit.

9 Huamarrjet

Huamarrjet më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Overdraft	17,265,145	18,132,446
Kesti Afatshkurter i Huase afatgjate	32,113,440	30,811,217
Kundravlefte ne Euro	259,607	253,028
Totali i Huamarrjeve afatshkurtra	49,378,586	48,943,663
	0	0
Hua Afatgjate	61,275,254	76,283,040
Kundravlefte ne Euro	495,354	626,452
Totali i Huamarrjeve afatgjata	61,275,254	76,283,040
Totali i Huamarrjeve	110,653,840	125,226,703

10 Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	34,449,057	48,719,064
Detyrime tatimore	1,286,525	1,182,922
Të tjera detyrime	150,960	150,960
Totali	35,886,542	50,052,946

“DEAPRINT” sh p k

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***10.1 Te pagueshme ndaj furnitoreve**

Te pagueshme ndaj furnitoreve më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Radin Print	18,984,441	32,194,284
Europaper sh.a	1,039,649	737,154
4 E Color	2,325,853	1,040,893
Algrafika shpk	4,059,422	3,646,541
Office Paper	3,284,667	3,040,240
OSHEE	560,163	1,264,710
Q I Press Controls	-	3,044,250
Albas	771,865	754,925
ESE	600,184	575,663
Mediaprint shpk	65,707	224,388
Rasim Daku	-	105,000
Lialb Gaz Energy sha	441,000	445,000
KBA MODLING GMBH	337,257	331,995
Albemilia shpk	491,684	428,048
Etna-al	46,800	183,000
ALEUS IEPS	232,550	-
Ardi shpk	178,609	-
Celesi shpk	139,110	-
Furnitor te ndryshem	890,098	702,973
Totali	<u>34,449,057</u>	<u>48,719,064</u>

10.2 Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim Page	144,572	436,799
Sigurime shoqerore	588,012	702,536
Tatim burim	27,026	43,586
TVSH	526,915	-
Totali	<u>1,286,525</u>	<u>1,182,922</u>

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Legjislacionit fiskal në Republikën e Shqipërisë, duke pasqyruar TVSH, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale si dhe ate në burim të llogaritur, të regjistruar drejt dhe të papaguar për detyrimin e krijuar në muajin dhjetor.

11 Parapagime

Parapagimet në vlerë 123,700 lekë më 31 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2019: 0 lekë) përfaqësojnë parapagime të bëra nga klientët për porosi të përfunduara pas datës 31 dhjetor 2020.

12 Kapitali

Kapitali themeltar, Rezerva, Fitim e Humbje më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kapitali i nenshkruar	628,196,000	628,196,000
Rezerva te tjera	4,048,857	3,530,780
Fitime/Humbje te vitit financiar	185,565	518,077
Totali	<u>632,430,422</u>	<u>632,244,857</u>

13 Shitjet neto

Shitjet neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shitje e produkteve të gatshëm	194,268,606	268,477,813
Shitje materiale	74,280	240,000
Shitje produkt mbeturine	520,610	691,457
Shitje sherbimi	1,031,108	959,003
Totali	<u>195,894,604</u>	<u>270,368,273</u>

14 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytezimit

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytezimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te ardhura nga Qeraja	6,720,000	6,720,000
Shitje AAM	-	738,000
Totali	<u>6,720,000</u>	<u>7,458,000</u>

15 Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet

Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet përfshinë shpenzimet për blerjen dhe prodhimin e produkteve të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kosto e lendeve te para dhe mat ndihmese	119,710,371	183,306,108
Totali	<u>119,710,371</u>	<u>183,306,108</u>

16 Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime energjie	10,037,339	12,658,908
Materiale të tjera	4,650,889	8,132,406
Sherbime nga të tretë	7,522,511	10,434,420
Sherbime juridike dhe ekspertimi	385,250	319,767
Shpenzime transporti	1,056,899	1,326,230
Prime sigurimi	98,458	117,970
Shpenzime telefoni	719,696	742,044
Shërbime bankare	470,403	631,753
Taksa	1,645,943	1,479,888
Të tjera	392,165	233,982
Vlera kontabël e AAM të shitura	-	1,196,616
Shpenzime të panjohura dhe penalitete	381,468	454,501
Totali	<u>27,361,021</u>	<u>37,728,485</u>

Tarifa e Auditimit Ligjor është 300 mijë lekë pa TVSh, vlerë e cila përfshihet në shpenzime juridike dhe ekspertimi.

17 Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga	32,817,835	35,479,739
Sigurime shoqerore	4,683,494	4,851,078
Totali	<u>37,501,329</u>	<u>40,330,817</u>

18 Shpenzime Financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Fitim nga kembime valutore	121,392	3,179,384
Shpenzim nga kembime valutore	(2,878,380)	(817,686)
Shpenzime per interesa	(5,186,396)	(5,492,509)
Totali	(7,943,384)	(3,130,811)

19 Tatimi mbi Fitimin

Llogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Fitim Bruto	285,630	770,641
Shpenzime te pa njohura	381,468	913,117
Humbje e mbartur		
Baza llogaritjes së Tatimit	667,098	1,683,758
% e tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	100,065	252,564
Fitimi NETO	185,565	518,077

20 Deklarimi i te Ardhurave

Te ardhurat ne bilanc krahasuar me Formularin e Deklarimet e Pageses TVSH jane te njejta si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
F.D.P.	202,614,602	277,826,307
Bilanc	202,614,604	277,826,273
<i>Diference I</i>	(2)	34

21 Ngjarjet pas bilancit

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës së raportimit, e cila kërkon dhënie informacioni shtesë apo ndonjë rregullim në pasqyrat financiare.